



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 37.3, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 13.01.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. KRENARE LATIFI-KQIKU** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Arbëresha Kryeziu -Hyseni
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Krenare Latifi Kqiku dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 09.01.2020, Nr.09/2020, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Arbëresha Kryeziu -Hyseni, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Kosovës, nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur e cila është, znj. Krenare Latifi- Kqiku, ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 13.01.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka